



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 34 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika (4), nenit 93 pika (4) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 4, pika 3, të Rregullores për Punë të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, dekreteve të Presidentit të Republikës së Kosovës për themelimin e misioneve diplomatike në nivel ambasade, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008 mori

V E N D I M

1. Emërohen sekretarët e parë në misionet diplomatike jashtë vendit.

2. Emërimi i sekretarëve është për një kohë të papërcaktuar.

3. Sekretarët e parë të emëruar janë:

- | | |
|---------------|---------------------|
| 1) Uashington | - Jetish Jashari |
| 2) Londër | - Bejtullah Destani |
| 3) Paris | - Sanije Bajraktari |
| 4) Berlin | - Islam Spahiu |
| 5) Romë | - Avni Manaj |
| 6) Bruksel | - Skënder Durmishi |
| 7) Ankara | - Güner Uraya |
| 8) Vjenë | - Hilmi Zogiani |
| 9) Bernë | - Artana Bardhi |
| 10) Tiranë | - Gani Veseli |

4. Ali Kryeziu dhe Arta Rama emërohen në Nju Jork.

5. Emërimi i të dërguarve në Nju Jork është për një kohë të papërcaktuar.
6. Pagat e të ngarkuarve me punë janë 2.600 Euro, ndërsa pagat e përcjellësve të tyre janë 2.100 Euro, deri në nxjerrjen e aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë shumën e pagave për anëtarët e shërbimit diplomatik.
7. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS NË INSTITUCIONET E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Orari i punës në institucionet e Republikës së Kosovës është 40 orë pune në një javë (orar i plotë i punës).
2. Orari i punës përcaktohet me fillim në orën 08:00 dhe përfundim në orën 16:00.
3. Përgjashtime në orarin e punës, sipas paragrafit 2, bëhen në institucionet ku puna zhvillohet me ndërime.
4. Punonjësi ka të drejtë pushimi gjatë punës ditore për një (1) orë.
5. Pushimi gjatë punës ditore përcaktohet me fillim në orën 12:00 dhe përfundim në orën 13:00.
6. Koha e pushimit, nga paragrafi 5, llogaritet në orarin e punës.
7. Punonjësi pushimin mund ta shfrytëzojë brenda ose jashtë ambienteve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

8. Mosardhja pa arsye në punë në kohën e caktuar dhe shkuarja nga puna para skadimit të orarit të punës konsiderohet si shkelje disiplinore e që për rrjedhojë ka shqiptimin e ndëshkimit përkatës.
9. Nëse pushimi nuk shfrytëzohet në ditën rrjedhëse, kjo e drejtë nuk kalon në ditën e ardhshme.
10. Obligohen institucionet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha aktet tjera që kanë rregulluar këtë lëmi.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4 dhe 6, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 2 të Urdhëresës administrative nr. 2003/25, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M
PËR PAGESËN E TRAJNERËVE TË ANGAZHUAR NË INSTITUTIN E
KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

1. Angazhimi, kategorizimi dhe kushtet që duhet plotësuar për të qenë trajner në Institutin e Kosovës për Administratë Publike – IKAP do të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 2004/09 për pagesën e trajnerëve të angazhuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.
2. Tarifat e pagesës së trajnerëve të angazhuar nga IKAP do të jenë si në vijim:
 - 1) Trajner i kategorisë së parë – 120 (njëqind e njëzetë) Euro
 - 2) Trajner i kategorisë së dytë – 100 (njëqind) Euro
 - 3) Trajner i kategorisë së tretë – 80 (tetëdhjetë) Euro
3. Shuma e përcaktuar në pikën 2 nënkupton shumën bruto dhe çfarëdo takse apo tatimi i aplikueshëm në Kosovë, në të ardhurat mbi këtë bazë, është barrë e trajnerit.
4. Pagesa e trajnerëve sipas pikës 2 do të bëhet për të gjitha pagesat e papaguara nga IKAP nga data 1 janar 2008.

5. Pagesa e trajnerëve do të bëhet nga Buxheti i IKAP-it i dedikuar për këtë qëllim.
6. Obligohet Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha aktet tjera që kanë rregulluar këtë lëmi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/35
Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për pagesën e anëtarëve të jashtëm të këshillave/komisioneve të cilat veprojnë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
2. Pagesa bëhet vetëm për anëtarët që nuk janë shërbyes civilë ose zyrtarë të një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, konform nenit 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë”.
3. Këshillat nga paragrafi 1 i këtij vendimi janë:
 - 1) Këshilli për Rregullimin dhe Vëzhgimin e Sektorit të Naftës në Kosovë
 - 2) Këshilli për Akreditim
 - 3) Këshilli Konsultativ për NVM-ët
 - 4) Komisioni për dhënie e licencave ndërmarrjeve ndërtimore, projektuese, reviduese, të mbikëqyrjes, të pranimit teknik dhe të laboratorëve të kontrollit të materialeve të ndërtimit
 - 5) Këshilli për licencim, klasifikim dhe kategorizim të objekteve hoteliere
 - 6) Këshilli profesional i standardizimit.

4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/35
Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për bartjen e tri projektligjeve nga Strategjia Legjislative e vitit 2008 në Strategjinë Legjislative të vitit 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës:
 - Projektligji për krijuesit e lirë dhe artistët e pavarur
 - Projektligji për muzetë
 - Projektligji për Estradën Kosovare
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/35
Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Hiqen ndëshkimet për borxhet tatimore aktuale dhe të arritura sipas kushteve në vijim:
 - 1) Ky vendim zbatohet për të gjithë tatimpaguesit që bëjnë pagesën e tatimit dhe interesit të arritur dhe/ose për tatimpaguesit që hyjnë në marrëveshje me Administratën Tatimore të Kosovës për pagesë të tatimit dhe interesit të arritur.
 - 2) Efektet juridike nga ky vendim rrjedhin nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi e deri më 31 dhjetor 2008.
 - 3) Lirimi nga borxhet tatimore përfshinë të gjitha llojet e ndëshkimeve për të gjitha borxhet tatimore të pashlyera që i ka borxh ose të arritura pas datës së nënshkrimit të këtij vendimi. Tatimpaguesit që kanë hyrë në marrëveshje me ATK-ën para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të hyjnë në marrëveshje të re që përfshinë bilancin e mbetur të ndëshkimeve, në mënyrë që ta gëzojnë përfitimin e këtij vendimi.
 - 4) Kohëzgjatja maksimale e marrëveshjes për pagesë, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, është 12 muaj nga data e lidhjes, ndërsa pagesa minimale mujore është në vlerë prej 200 Euro në muaj.
 - 5) Heqja e ndëshkimeve bëhet vetëm pasi të jetë shlyer tërësisht tatimi dhe interesi që ka qenë borxh, si është paraparë me marrëveshje.

- 6) Gjatë kësaj periudhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave autorizohet që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të zgjidhur situatën e borxheve të tatimpaguesve me status juridik të “Organizatës buxhetore”, “Ndërmarrjes shoqërore” dhe “Ndërmarrjes publike”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Administrata Tatimore e Kosovës në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, e cila do të sigurojë procedura të qarta për ekzekutim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. 06/260 i datës 18/07/2007, si vijon:
 - 1) Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje - Përcaktohet vlera e sulfurit në vajrat për ngrohje në lartësi deri në 2 %.
 - 2) Pikat 2, 3 dhe 4 nga vendimi i mëparshëm bëhen pikat 3, 4 dhe 5, sipas vendimit të ri.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/35

Datë: 10.09.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Masat Antidamping.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë